



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada- Government

2013-2018

**STRATEGJIA SHITETËRORE PËR MIGRIM
DHE PLANI I VEPRIMIT 2013-2018**

Shtator 2013, Prishtinë

Përmbajtja	
Shkurtesat.....	4
I. Përmbledhje ekzekutive	5
II. Hyrje.....	6
III. Parimet	7
IV. Baza ligjore.....	8
V. Metodologjia	10
VI: Sfondi – Përshkrimi dhe definimi i çështjes/problemit kryesor	13
6.1. Shpjegim.....	13
6.2.Politika aktuale.....	16
6.3 Programi aktual për migrim	16
6.4 Bashkëpunimi me Organizatat Ndërkombëtare	16
6.5 Bashkëpunimi me shoqërinë civile.....	17
6.6 Kontrolli në kufi dhe politika e vizave	17
6.7 Ripranimi dhe Kthimi	18
6.8 Luftimi i trafikimit me njerëz	21
6.9 Azili.....	23
6.10 Shtetësia dhe procedurat	25
6.11 Parandalimi dhe luftimi i migrimit të parregullt brenda Republikës së Kosovës	25
VII. Politikat e ardhshme	26
7.1 Kontrolli kufitar.....	26
7.2 Politika e vizave	27
7.3 Migrimi i parregullt dhe kthimi në vendin e origjinës	27
7.4 Luftimi i trafikimit me njerëz.....	28
7.5 Politikat e azilit.....	29
7.6 Politikat e migrimit, zhvillimit dhe të integritimit.....	29
7.7 Përmirësimi i sistemit institucional dhe krijimi i mekanizmave	30
7.8 Migrimi ligjor	30
7.9 Profili i Migrimit.....	31
VIII. Kuadri Strategjik	32
8.1 Vizioni.....	32
8.2. Misioni	32
IX. Objektivat strategjike.....	32

X. Instrumentet Ndërkombëtare.....	33
XI. Zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi i strategjisë.....	33
11.1 Roli i sistemit të monitorimit	33
11.2. Strukturat institucionale për monitorim dhe vlerësim.....	34
11.3. Zgjedhja e treguesve të monitorimit dhe vlerësimit.....	34
11.4 Instrumentet e monitorimit dhe vlerësimit.....	35
11.5 Shpërndarja dhe përdorimi i rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit.....	35
XII. PLANI I VEPRIMIT	36
XIII. Anekset.....	36
13.1 Korniza ligjore.....	36
13.2 Instrumentet ndërkombëtare.....	37

Shkurtesat

AKI	Agjencia e Kosovës për Inteligjencë
AKK	Agjencia Kosovare Kundër Korrupsionit
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
PK	Policia e Kosovës
DK	Doganat e Kosovës
DSHAM	Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion
DKO	Drejtoria për Krimin e Organizuar
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
ICITAP	Programi Ndërkombëtar i Asistencës për Trajnim në Hetimet Penale
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
KPK	Kodi Penal i Kosovës
KPPK	Kodi i Procedurës Penale i Kosovës
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MD	Ministria e Drejtësisë
MeD	Ministria e Diasporës
MEI	Ministria e Integritimit Evropian
MF	Ministria e Financave
MIK	Menaxhimi i Integruar i Kufirit
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
OSCE	Organizata për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë
UNHCR	Komisari i Lartë për Refugjatë i OKB-së
ZKM	Zyra e Kryeministrit

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Strategjia për Migrim 2013-2018 adreson zotimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës të parandalojë migrimin e parregullt dhe të fuqizojë migrimin e rregullt, duke avancuar dhe lehtësuar migrimin ligjor dhe njëkohësisht t'a shndërroj migrimin në faktor pozitiv për zhvillimin ekonomik dhe njëkohësisht shpreh gatishmërinë të kyçet në dialogun dhe bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar, me qëllim të identifikimit të prioritetëve të përbashkëta dhe adresimit të sfidave të përbashkëta me qëllim të fuqizimit të menaxhimit bilateral dhe regional të migrimit.

Nëpërmjet Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Migracion 2013-2018, synohet administrimi i migrimit dhe forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional dhe bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar më synim kryesor parandalimin e migrimit të parregullt dhe luftimin e trafikimit me migrantë. Po ashtu, strategjia synon përfshirjen në këtë vizion edhe të organizatave ndërkombëtare respektive dhe shoqërinë civile.

Ky dokument strategjik ndahet në dy pjesë: Strategjia për Migrim dhe Plani i Veprimit, i cili përmban objektivat dhe aktivitetet që planifikohen të përmbushen në periudhën pesë vjeçare 2013 – 2018.

Obektivat strategjike dhe specifike, si dhe aktivitetet janë të paraqitura detajisht në Planin e Veprimit, i cili po ashtu përmban institucionet përgjegjëse, pjesën buxhetore dhe indikatorë të matshëm dhe konkret.

Realizimi i misionit të kësaj strategjie, synohet të arrihet përmes realizimit të objektivave strategjike si më poshtë:

- parandalimi dhe luftimi i migrimit të parregullt;
- përmirësimi i menaxhimit të migrimit ligjor dhe qarkullues;
- transformimi dhe zhvillimi i migracionit në faktor pozitiv ekonomik.

Për më tepër, secili nga tre objektivat strategjik ngërthen në vete objektivat specifik të cilët janë përshkruar taksativisht tek pjesa e përgjithshme e Strategjisë.

II. HYRJE

Migrimi si proces i përhershëm i lëvizjes së njerëzve si dhe rritja e vazhdueshme e numrit të migrantëve dhe problemet që ndërlidhen me këtë, ka ndikuar që migrimi të gjendet në qendër të vëmendjes në shumë shtete të botës. Pothuajse të gjitha vendet, pa dallim, ballafaqohen me sfida që ndërlidhen me migrimin, qofshin si vende të origjinës, transitit apo vende të destinacionit përfundimtar. Kjo bëhet edhe më aktuale në ditët e sotme, posaçërisht duke pasur parasysh faktin se përafërsisht, vlerësohet se në ditët e sotme jetojnë diku rreth 214 milion njerëz jashtë vendit të vendlindjes së tyre ose 3% e numrit të përgjithshëm të njerëzimit, dhe se ky numër ka pësuar rritje enorme, veçanërisht në 20 vitet e fundit. Gjatë periudhës së viteve 1965-1990, numri i migrantëve, ndërkombëtarisht është rritur për 45 milion, me një shkallë rritje prej 2.1% për vit, përderisa shkalla e tanishme e rritjes është 2.9% në vit. Po ashtu, numri i përgjithshëm i migrantëve në nivel global, ka pësuar rritje këto vitet e fundit, nga diku rreth 150 milion në vitin 2000, në 214 milion në kohët e sotme, që i bie se çdo i 33 njeri sot është migrant (përderisa në vitin 2000, ka qenë çdo i 35)¹.

Kjo rritje është ndjerë edhe në Ballkanin Perëndimorë dhe Republikën e Kosovës si pjesë e Ballkanit Perëndimor, ku ka pasur rritje të konsiderueshme të migrantëve të parregullt, dhe atë kryesisht nga vendet si: Afganistani, Pakistani, Bangladeshi, Algjeria, Maroku, Kongo, Siria, etj. Kjo rritje sipas këtij raporti vjen kryesisht përmes Turqisë në Greqi dhe pastaj nga Greqia në Shqipëri apo Maqedoni ku vazhdohet për në vendet tjera, duke përfshirë edhe Republikën e Kosovës.²

Bazuar në të gjitha këto, Republika e Kosovës ka ndërmarrë një varg masash me qëllim të menaxhimit sa më efikas të migrimit si dhe zvogëlimit dhe parandalimit të efekteve negative që burojnë posaçërisht nga migrimi i parregullt. Në këtë aspekt, Republika e Kosovës ka hartuar dhe miratuar një varg ligjesh dhe akte nënligjore, dokumente strategjike dhe dokumente tjera. Në mesin e këtyre vlen të veçohen, Ligji për Azilin, Ligji për të Huajt, Ligji për Kontrollin e Kufirit, Ligji për Shtetësinë e Kosovës, Strategjinë për Menaxhimin e Integruar të Kufirit, Strategjinë për Luftimin e Trafikimit me Njerëz, si dhe janë plotësuar dhe ndryshuar një numër i ligjeve përfshirë këto që u përmendën më lartë, si dhe disa ligjeve të reja, ku vlen të përmendet Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit . Po ashtu, Qeveria e Republikës së Kosovës ka lidhur një numër të marrëveshjeve bilaterale me

¹ Kjo shifër është shifër e përafërt e dhënë nga IOM. Këto të dhëna mund të gjenden në faqen e IOM: <http://www.iom.int/cms/en/sites/iom/home/about-migration/facts--figures-1.html>. Këto të dhëna reflektohen edhe në COMMUNICATION FROM THE COMMISSION TO THE EUROPEAN PARLIAMENT, THE COUNCIL, THE EUROPEAN ECONOMIC AND SOCIAL COMMITTEE AND THE COMMITTEE OF THE REGIONS - Maximising the Development Impact of Migration The EU contribution for the UN High-level Dialogue and next steps towards broadening the development-migration nexus. Bruksel, 21.05.2013

² Ky raport mund të gjendet në faqen e FRONTEX: http://www.frontex.europa.eu/assets/Publications/Risk_Analysis/WB_ARA_2012.pdf

shumë shtete për ripranimin e personave dhe bashkëpunimin policor, dhe është në proces të negocimit të një numri të marrëveshjeve të tilla me disa shtete tjera.

Qeveria e Republikës së Kosovës është e vetëdijshme për ndikimet negative dhe pozitive të migrimit. Ndikimet negative kryesisht ndërlidhen me rrezikimin e sigurisë kombëtare, përfshirjes së migrantëve dhe të tjerëve në aktivitete të ndryshme kriminale dhe efekte tjera negative për vendin.

Sidoqoftë, Qeveria e Republikës së Kosovës është e vetëdijshme dhe e interesuar po ashtu të fuqizojë efektet pozitive të migrimit dhe posaçërisht ato që ndërlidhen me zhvillimin, aspekt i cili ndër të tjera do të trajtohet në këtë strategji.

III. Parimet udhëheqëse

Me qëllim të arritjes së objektivave strategjike, aktivitetet e institucioneve të Republikës së Kosovës do bazohen në parimet e mëposhtme:

1. Parimi i Ligjshmërisë: Ky parim nënkupton që veprimet e ndërmarra nga institucionet e Republikës së Kosovës në menaxhimin e migrimit duhen të bazohen në dispozitat e parapara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, legjislacionin në fuqi dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

2. Parimi i Integritimit: Përmes së cilit, sensibilizimi i publikut dhe rolit më aktiv qeveritar dhe jo qeveritar, të mundësohet dhe lehtësohet integrimi i të huajve në shoqërinë kosovare.

3. Parimi i Bashkëpunimit Ndërkombëtar: Në kuadër të së cilit sigurohet dialogu dhe bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare, qeveritare dhe jo qeveritare, si dhe vendet e tjera me qëllim të lehtësimit dhe bashkërendimit të politikave dhe aktiviteteve të migrimit.

4. Parimi i Mbrojtjes të së Drejtave të Njeriut: Ky parim nënkupton garantimin e lirive dhe të drejtave të njeriut gjatë të gjitha fazave të angazhimit të institucioneve në menaxhimin e migrimit në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe atë ndërkombëtar.

5. Parimi i Bashkëpunimit dhe Bashkërendimit: Ky parim nënkupton bashkëpunimin dhe bashkërendimin e brendshëm ndërinstitutional, partnerët social, rrjetet akademike, organizatat ndërkombëtare, qeveritare, jo-qeveritare dhe organizatat tjera vendore, me qëllim të luftimit të migrimit të parregullt dhe promovimit të migrimit të rregullt.

6. Parimi i Transparencës: Ky parim nënkupton një qëndrim pro aktiv me qëllim të informimit të shoqërisë civile për rëndësinë që ka hartimi i një politike shtetërore për migrimin për zhvillimin dhe mbarësinë e Kosovës. Fushata të ndryshme duhen të organizohen me qëllim të luftës kundër ksenofobisë dhe promovimit të diversitetit kulturor.

IV. Baza ligjore

Republika e Kosovës ka kornizë ligjore e cila në mënyrë të drejtpërdrejt dhe indirekte e rregullon çështjen e migrimit në Kosovë. Duke u bazuar në kërkesat e udhërrëfyesit për liberalizim të vizave, është harmonizuar legjislacioni shtetëror në përputhje me legjislacionin e BE-së në çështje të migrimit dhe azilit. Harmonizimi i legjislacionit është element kyq për implementimin e politikave të përbashkëta të migrimit dhe për të siguruar menaxhim efektiv të migrimit në të gjitha fazat, trajtim korrekt të shtetasve të vendeve të treta me qëndrim të rregullt në Kosovë dhe parandalimin e emigrimit të parregullt si dhe luftimin më të fuqishëm të kontrabandimit me migrantë dhe trafikimit me njerëz.

Në kontekst të kësaj, Qeveria e Republikës së Kosovës ka bërë rishikimin e ligjeve si në vijim:

Ligji për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror

Me këtë ligj rregullohet kontrolli kufitar, kompetencat e policisë brenda shtetit, bashkëpunimi ndërmjet organeve shtetërore të cilat kanë kompetencë në menaxhimin kufitar. Kontrolli kufitar bëhet me qëllim të parandalimit, zbulimit dhe ndalimit të migrimit të parregullt dhe përfshinë masat për parandalimin e kalimeve të paligjshme të kufirit dhe veprimtarive të tjera të paligjshme të bëra nëpërmjet kufirit.

Ligji për të Huajt

Ligji për të Huajt rregullon kushtet e hyrjes, lëvizjes, qëndrimit dhe punësimit të të huajve në Republikën e Kosovës. Ky ligj është harmonizuar plotësisht me legjislacionin e BE-së që rregullon këtë fushë dhe rregullon migrimin e rregullt, sanksionon migrimin e parregullt, si dhe përmban dispozita për integrimin e të huajve në shoqërinë kosovare.

Ligji për Azil

Ky ligj rregullon dhënien e azilit dhe njohjen e statusit të refugjatit, dhënien e statusit të mbrojtjes plotësuese apo të përkohshme, personave që kanë nevojë si dhe kthimin e tyre në vendin e origjinës, të prejardhjes ose në një vend të tretë.

Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i dispozitave juridike përmes të cilave, autoriteteve kompetente vendore iu jepen të drejta, obligime dhe përgjegjësi, për parandalimin dhe luftimin e trafikimit në të gjitha format e tij, mbrojtjen e viktimave të trafikimit, dhe përcakton mënyrat e bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar në mënyrë që të parandalohet dhe luftohet trafikimi. Ky ligj gjithashtu parasheh mbrojtjen dhe asistencën për viktimat e trafikimit.

Ligji për Ripranim

Ligji për Ripranim ka për qëllim që të adresoj të gjitha çështjet të cilat kanë të bëjnë me procedurat për ripranimin e personit i cili është shtetas i Republikës së Kosovës ose i huaj, i cili nuk përmbush ose nuk përmbush më, kushtet në fuqi për hyrje apo qëndrim në territorin e shtetit

kërkues. Ripranimi është “akti me anë të të cilit një shtet pranon ri-hyrjen e një personi (shtetas të tij, shtetas të vendeve të treta ose persona pa shtetësi), që ka hyrë, qëndron ose banon në mënyrë të paligjshme në një shtet tjetër.

Ligji për Vendbanimin dhe Vendqëndrimin

Me këtë ligj rregullohet në mënyrë unike lajmërimi dhe ç’lajmërimi i vendbanimit dhe vendqëndrimit të qytetarëve, lajmërimi dhe ç’lajmërimi i mysafirëve, ndërrimi i adresave të banimit, kompetencat dhe mënyra e mbajtjes së evidencave përkatëse.

Ligji për Shtetësinë e Kosovës

Ligji për Shtetësinë e Kosovës përcakton mënyrën e fitimit, rifitimit dhe humbjes së shtetësisë së Republikës së Kosovës dhe rregullohen çështje të tjera të ndërlidhura me shtetësinë e Republikës së Kosovës. Ndërsa me Ligjin nr. 04/L-059 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-034 për Shtetësinë e Kosovës, është rregulluar mënyra e fitimit të shtetësisë së Kosovës nga persona pa shtetësi-apatrid. Po ashtu, për personat nën moshën katërbëdhjetë (14) vjeçare për humbjen e shtetësisë së Kosovës kërkohet humbja e shtetësisë vetëm të njërit prind dhe me pëlqimin e prindërit tjetër.

Ligji për Mërgatën e Kosovës

Ligji për Mërgatën e Kosovës ndihmon në organizimin e mërgatës në shtetet e ndryshme ku jeton mërgata kosovare. Ky ligj ka për qëllim ruajtjen dhe kultivimin e identitetit gjuhësor, kulturor e arsimor të pjesëtarëve të mërgatës dhe lidhshmërinë e tyre me institucionet e Republikës së Kosovës. Po ashtu, ligji ndihmon në organizimin e mërgatës në shtetet e ndryshme ku jeton mërgata kosovare, nxitë dhe zhvillon marrëdhënie ndërkulturore në mes të Republikës së Kosovës me shtetet ku mërgata është prezente.

Ligji për Gjendjen Civile

Ky ligj rregullon kuptimin dhe përbërësit e gjendjes civile të shtetasve të Kosovës, shtetasve të huaj dhe të personave pa shtetësi, me banim të përkohshëm apo të përhershëm në Republikën e Kosovës, përcaktimin e rregullave për krijimin, ruajtjen dhe ndryshimin e tyre, si dhe organizimin dhe funksionimin e shërbimit të gjendjes civile në Republikën e Kosovës.

Ligji për bashkëpunim ndërmjet autoriteteve të përfshira në menaxhimin e integruar të kufirit

Qëllimi i këtij ligji është rregullimi i bashkëpunimit ndërmjet të gjitha autoriteteve publike përkatëse që janë të përfshira në MIK dhe zbatimi i strategjive të përbashkëta të këtyre autoriteteve, në mënyrë që detyrat e parapara për këto autoritete dhe masat individuale që kanë të bëjnë me parandalimin, zbulimin dhe hetimin e aktiviteteve të kundërligjshme penale, kontrollin, monitorimin dhe bashkëpunimin përkatës ndërkombëtar, të përmbushen në mënyrë të duhur, efikase dhe efektive.

V. Metodologjia

Në hartimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit janë angazhuar të gjithë akterët që në përgjegjësitë e tyre institucionale preken nga veprimi i migrimit në format e tij. Grumbullimi i dokumenteve dhe materialeve si dhe studimi i problemeve dhe çështjeve që kanë rezultuar nga dokumenti paraprak, janë sistemuar në tekstin e Strategjisë dhe do të përkthehen në Planin e Veprimit me aktivitete specifike dhe indikatorë të matshëm për përmbushjen e tyre.

Gjatë fazës së parë të hartimit të strategjisë, shumë palë të interesuara vendore dhe ndërkombëtare, janë njoftuar me konceptin bazë të nevojës për një strategji. Në përpilimin e strategjisë, grupi është bazuar në të gjitha dokumentet e qeverisë si dhe strategjitë që përfshijnë migrimin, azilin dhe politikat për riintegrimin, në mënyrë që të vendosë drejtimin e saj.

Si pasojë, është vendosur të bëhet unifikimi i komponenteve kyçe të kësaj strategjie, menaxhimit të migrimit dhe bërjen e migrimit faktor ekonomik. Si e tillë, kjo strategji ofron një përmbledhje të politikave dhe udhëzimeve të cilat reflektojnë në pjesë të saj. Për më shumë, grupi ka qenë i informuar rreth procesit të përgjithshëm të formulimit të strategjive të cilat po përgaditen dhe zbatohen nga të gjitha ministrinë, agjencitë dhe komunat. Gjatë përpilimit të kësaj strategjie janë zhvilluar shumë konsultime të burimeve statistikore dhe burime tjera.

Ky grup është falenderues UNHCR-it, IOM për të dhënat statistikore në fushën e kthimeve dhe anketave lidhur me kushtet shoqërore-ekonomike (nevojat e komuniteteve) në Kosovë, të kryera përmes projekteve. Gjithashtu, falënderon kontributin e dhënë në hartimin e Strategjisë të përfaqësuesëve nga ICITAP dhe EULEX.

Përveç kësaj, shumë nga studimet lidhur me migrimin në Kosovë janë përdorur si mjete analitike dhe dokumentuese. Ministria, dëshiron të falenderoj të gjithë ata që kanë qenë pjesëmarrës në hulumtimin dhe analizimin e sektorit të migrimit në Kosovë. Si pjesë e ushtrimit konsultativ një numër i institucioneve të Qeverisë, ministrinë relevante si dhe partnerët ndërkombëtarë kanë ofruar kontributin e tyre në hartimin e strategjisë.

Si pjesë e procesit të hartimit të strategjisë, janë shikuar edhe praktikat e vendeve të rajonit në menaxhimin e migrimit.

Gjatë hartimit të strategjisë janë adresuar kërkesat nga udhërrefyësi për liberalizim të vizave, si dhe të gjeturat nga Komunikata e Komisionit për Studimin e Fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit mes Bashkimit Evropian dhe Kosovës e datës 10 tetor 2012 (dhe Raporti i Komisionit Evropian të 8 shkurtit 2013 mbi progresin e Kosovës për përmbushjen e kërkesave që dalin nga udhërrefyësi për liberalizim të vizave). Duhet të konstatojmë se Kushtetuta e Republikës së Kosovës është dokumenti udhëzues për këtë strategji.

Mekanizmat institucional

Institucionet përgjegjëse për mbikëqyrje dhe zbatim të politikës aktuale përbëhen nga një sërë institucioneve qeveritare, të gjitha me detyra dhe përgjegjësi specifike të detajuara si në vijim:

1. Koordinatori Nacional - përgjegjës për koordinimin, bashkërendimin, monitorimin dhe raportimin e implementimit të politikave, aktiviteteve dhe veprimeve të parapara me Strategjinë për Migrim.

2. Sekretariati – Grumbullimi i të dhënave dhe raporteve nga institucionet tjera, me qëllim të analizimit dhe vlerësimit të tyre si dhe përgatitja e raporteve për Koordinatorin Nacional. Rolin e Sekretariatit e kryen DSHAM.

3. Ministria e Punëve të Brendshme- MPB ka rol funksional në arritjen e objektivave të caktuara në këtë strategji. Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion (DSHAM) është departamenti kryesor në implementimin e kësaj strategjie, ligjeve dhe politikave që kanë të bëjnë me migrimin. DSHAM është përgjegjës për koordinimin e procesit të migrimit dhe zhvillimin e politikave të migrimit, për rregullimin dhe kontrollin e migrimit të të huajve me qëndrim në Kosovë dhe për përcjelljen e të huajve të cilët janë subjekt i deportimit apo largimit me forcë në kufirin shtetëror.

Divizioni i Azilit - Është përgjegjës për njohjen e azilit dhe statusin humanitar të të huajve në Kosovë. Përgjegjësit e tij përfshijnë vendimmarrjen për refugjatë dhe rastet e azilit, bashkëpunimin me institucionet tjera kompetente të Kosovës të përfshira në çështjet e azilit.

Divizioni për Shtetësi - Kompetencat e tij përfshijnë pranimin dhe verifikimin e kërkesave për fitimin e shtetësisë me natyralizim si dhe shqyrton kërkesat për lirim nga shtetësia e Kosovës.

Divizioni për të Huaj - Kompetencat e tij përfshijnë shqyrtimin e kërkesave për lejeqëndrim në Republikën e Kosovës, si dhe është pjesë e procesit vendimmarrës për lëshimin e vizës.

Divizioni për Ripranim dhe Kthim – Shqyrtimi i kërkesave për ripranim për shtetasit tanë dhe të personave të vendeve të treta dhe realizimi i kërkesave për ripranim, si dhe kthimi i të huajve në vendin në bashkëpunim me institucionet tjera relevante.

Divizioni për Planifikim, Strategji dhe Statistika - Është përgjegjës për grumbullimin dhe sistemimin e të dhënave në fushën e migrimit.

Policia Kufitare - Është përgjegjëse për menaxhimin dhe kontrollin e kufijve kundër migrimit të parregulltë dhe trafikimit me njerëz. Policia Kufitare bashkëpunon dhe ndërvepron me organet të cilat kanë kompetencë në çështjet me azil, refugjatë dhe qëndrimin e të huajve, me qëllim të arritjes së kontrollit dhe menaxhimit efektiv të migrimit, si dhe mbikëqyrë pikë kalimet kufitare dhe vijën e gjelbërt dhe blu. Drejtorja për Migrim dhe të Huaj është përgjegjëse për plotësimin e kërkesës fillestare për azilkërkuesit.

Drejtorja për Hetimin e Trafikimit – Si organ i specializuar i Policisë së Kosovës është i ngarkuar me përgjegjësinë e hetimit, arrestimit dhe ndjekjes penale të trafikantëve dhe kryersve të veprave penale të trafikimit me njerëz.

Koordinatori Nacional i Kosovës kundër Trafikimit – Organizon dhe koordinon bashkëpunimin ndërmjet agjencive dhe organizatave relevante për zbatimin e politikave kundër

trafikimit me njerëz. (Ligjet, Strategjia dhe Plani i Veprimit kundër Trafikimit me Njerëz). Koordinatori Nacional përcakton dhe administron zbatimin e politikës shtetërore në luftimin e trafikimit me njerëz. Element i rëndësishëm i punës së Koordinatorit Nacional është parandalimi i grupeve të rrezikuara me trafikim me njerëz dhe zhvillimi i politikës për mbrojtje, përkrahje dhe riintegrim të viktimave të trafikimit.

4. Ministria e Punëve të Jashtme- MPJ është përgjegjëse për zbatimin e regjimit të vizave. Departamenti për Çështje Konsullore brenda MPJ- së është autoriteti qendror në të cilin vendoset Qendra e Sistemit Informativ të Vizave të Kosovës. Sipas legjislacionit vendor, misionet diplomatike dhe konsullore janë përgjegjëse për lëshimin e vizave. Për rastet e jashtëzakonshme ka përjashtim nga ky rregull i përgjithshëm. Gjithashtu, kjo ministri është një ndër akterët kyç në proceset e lidhjes së marrëveshjeve të ripranimit.

5. Ministria e Arsimit, Shkencës, dhe Teknologjisë- MASHT ka programe për të stimuluar studentët kosovarë që studiojnë jashtë kufijve shtetëror me skema të ndryshme të bursave përmes marrëveshjeve bilaterale me vendet e ndryshme. Po ashtu, stimulon studentët e huaj për ardhje në Republikën e Kosovës përmes kurseve akademike verore si dhe programeve tjera.

6. Ministria e Integritimit Evropian- Bën monitorimin dhe siguron cilësinë e raportimeve të rregullta për implementimin e Planit të Veprimit për Partneritet Evropian, Planit të Veprimit të Studimit të Fizibilitetit, dokumenteve tjera thelbësore lidhur me procesin e zhvillimit dhe integritimit evropian, ku çështje shumë e rëndësishme janë zhvillimet në fushën e migrimin.

7. Ministria e Diasporës - MeD përmes njoftimit, sensibilizimit në vendet nga ku paraqiten flukse të migrantëve, dhe angazhohet në marrjen e veprimeve për organizimin e jetës kulturore për qytetarët jashtë vendit, identifikimin e tyre dhe kategoritë tjera.

8. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – MPMS është përgjegjëse për formulimin dhe implementimin e politikave për pranimin e shtetasve të huaj në tregun e punës, për nënshkrimin e marrëveshjeve bilaterale për punësim dhe marrëveshjeve për sigurimin social me vendet tjera, për asistimin e shtetasve të Kosovës në vendet tjera anëtare dhe shtetasve të shteteve anëtare në Kosovë, të cilat ushtrojnë punësimin e tyre dhe të drejtat e sigurimit social të qytetarëve të BE-së, për koordinimin e politikës së Kosovës për integrimin e shtetasve të vendeve të tjera.

Departamenti i Punës – Është përgjegjës për zbatimin e politikave për mbrojtjen e tregut të punës dhe pranimin e shtetasve të vendeve të tjera për punësim. Departamenti nëpërmjet zyreve të saj regjionale, bën regjistrimin e punëkërkuesve të huaj në Kosovë.

9. Banka Qendrore e Kosovës – Ka për qëllim krijimin e një sistemi të pagesave të drejtpërdrejta përmes bankave komerciale, e cila mundëson që dërguesit e parave të ofrojnë mbështetje për familjet dhe të afërmit e tyre në vendin e tyre duke dërguar remitancat.

10. Ministria e Drejtësisë – Mundëson ndihmën e ndërsjellë juridike në mes të Republikës së Kosovës dhe shteteve të huaja, në të cilët jetojnë shtetasit kosovar. MD mundëson transferin e personave të dënuar nga shtetet tjera në Republikën e Kosovës dhe anasjelltas, shërbimin e

dokumenteve gjyqësore, pranon reportet lidhur me sjelljet kriminale të shtetasve tanë që jetojnë në shtetet tjera, si dhe mundëson çdo ndihmë tjetër me karakter juridik ndërkombëtar.

11. Ministria e Financave – MF është institucion përgjegjës që të sigurojmë rritjen e të hyrave buxhetore, monitorimin, menaxhimin e përgjithshëm financiar, të drejtë dhe transparent të fondeve publike, ka rol kyç në përcaktimin dhe implementimin e politikave financiare dhe fiskale të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

12. Këshilli Gjyqësor- Si një institucion i pavarur përgjegjës për administrimin e gjykatave, siguron pavarësinë dhe paanshmërinë e sistemit gjyqësor, jep garanci të fuqishme në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në pajtueshmëri me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ligjet në fuqi dhe konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. KGJK siguron që gjykatat veprojnë me kujdes dhe urgjencë të veçantë të lëndëve të cilat me ligj kërkohet shqyrtim i shpejtë, si dhe shmangjen e vonesave të panevojshme. Po ashtu, mundëson implementimin e memorandumeve të mirëkuptimit të lidhura në mës MD-së me ministrinë e drejtësisë së shteteve të huaja si institucione kompetente për njohjen e vendimeve gjyqësore në baza reciprociteti.

13. Këshilli Prokurorial – Është organ përgjegjës për emrimin e prokurorëve dhe orientimin e trajnimeve në avancimin dhe etikën profesionale të prokurorëve në Republikën e Kosovës.

14. Agjencia e Inteligjencës së Kosovës – Është institucion përgjegjës për kundërpërgjigjen ndaj presionit të migrimit në Kosovë të shoqëruar me vendosje të mundshme në territorin e vendit të personave që kanë lidhje me organizatat ndërkombëtare terrosite apo formacionet e kimit të organizuar që veprojnë në territorin e Kosovës.

15. Agjencia e Statistikave të Kosovës – Si institucion i pavarur dhe profesional i administratës publike të Kosovës ofron statistika objektive dhe analiza, përkrah departamentet e Qeverisë dhe siguron informata në fusha të caktuara.

Institucionet tjera me kompetenca relevante në fushën e migrimit janë – Ministria e Industrisë dhe Tregtisë, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve, si dhe Komunitatet e Kosovës.

VI: Sfondi – Përshkrimi dhe Definimi i Çështjes/Problemit Kryesor

6.1. Shpjegim

Migrimi është proces i lëvizjes që përfshin kalimin e kufirit ndërkombëtar dhe atë brenda një shteti. Kjo është një lëvizje dhe përfshinë çdo lloj të lëvizjes së njerëzve, pavarësisht nga kohëzgjatja, përbërja dhe shkaqet, përfshinë migrimin e refugjatëve personat e shpërngulur, persona të dëbuar dhe migrantë ekonomik.³

³ Fjalorth i terminologjisë migratore nr.10, E drejta Migratore Ndërkombëtare, IOM 2007, fq-45.

Migrimi është karakteristikë e të gjitha shoqërive. Për Republikën e Kosovës mbetet sfida largimi qytetarëve kosovarë në drejtim të shteteve të Evropës perëndimore për arsye të ndryshme ekonomike apo sociale.

Siç dihet migrimi i parregullt është në kundërshtim me parimet evropiane dhe rrezikon integrimin e Kosovës në BE dhe inkurajon trafikimin me njerëz nga krimi i organizuar dhe kontrabandimin me migrantë etj. Prandaj në parandalimin e migrimit të parregullt ndihmon edhe promovimi i migrimit të rregullt i natyrës ekonomike për qëndrime të shkurta si dhe për qëllim studimi dhe kërkimi, i cili migrim mbështetet dhe promovohet nga politikat e BE-së.

Qeveria e Republikës së Kosovës do të vazhdoj të ndërmerr të gjitha masat politike dhe sociale në menaxhimin e migrimit. Në kontekst të kësaj Qeveria e Republikës së Kosovës promovon migrimin e rregullt me qëllim të lehtësimit të udhëtimit në shtetet anëtare të BE-së dhe përfitimin nga programet e migrimit qarkullues⁴, që lehtëson qarkullimin e shtetasve ndërmjet Republikës së Kosovës me shtetet anëtare të BE-së në mënyrë ligjore, duke përfshirë migrimin për qëllime studimi, punësimin sezonal, shkëmbimin e eksperiencave si dhe trajnime të ndryshme.

Arsye kryesore e migrimit vazhdon të jetë papunësia dhe dëshira për të siguruar kushte më të mira të jetesës. Këtë më shumë e mbështesin të dhënat e publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës sipas të cilave rreth 40 % e kosovarëve janë të papunë.


Sipas të dhënave të Eurostat⁵, nga tabela e mëposhtme, numri i azilkërkuesve kosovarë është zvogëluar për 46,2%, nga 14,310 sa ishin në 2010 në 9,790 në 2011. Në tremujorin e parë (K1) të vitit 2012 numri i azilkërkuesve ishte 1,970, ndërsa në tremujorin e dytë (K2) 2,015, që paraqet një rritje prej 2,3%. Nëse vazhdohet me këtë trend atëherë numri i azilkërkuesve për vitin 2012 do të arrijë rreth 8,000, që do të paraqiste një rënie prej 18.7% në krahasim me vitin 2011.

Sa i përket shënimeve për vitin 2012, vërehet se në krahasim me vitin 2011 ka ngritje në kuartalet 3 dhe 4, dhe atë në K3 për 28,8% dhe në K4 për 64,6%, gjë që shihet edhe nga grafiku 1.

Viti	Total	K1	K2	K3	K4
2010	14310	3235	3040	3525	4510
2011	9790	3095	2535	1945	2215
2012	10135	1970	2015	2505	3645

⁴ Komunikata e KE-së 2007, migrimi qarkullues mund të përkufizohet si “Një formë e migrimit e cila menagjohet në atë mënyrë që lejon disa shkallë të mobilitetit ligjor poshtë e lartë në mes të dy shteteve”.


⁵ Eurostat, popullata dhe kushtet sociale.



Grafiku 1.

Në grafikun 2. është e paraqitur pjesëmarrja e azilkërkuesve kosovarë në shtetet e BE-së.

Azilkërkuesit kosovar në shtetet e BE-së, në vitin 2012



Grafiku 2.

6.2. Politika aktuale

Qeveria e Republikës së Kosovës ka ndërmarrë një sërë veprimesh me qëllim të administrimit të migrimit duke aprovuar kornizën ligjore në fushën e migrimit në harmoni me legjislacionin e BE-së. Për më tepër, ajo ka miratuar dokumente strategjike si: Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, Strategjia Shtetërore e Republikës së Kosovës Kundër Krimin të Organizuar dhe Plani i Veprimit 2012-2017, Strategjia Shtetërore e Republikës së Kosovës për Parandalimin e Krimin dhe Plani i Veprimit 2009-2012, Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Kufirit 2012-2017 dhe Strategjia Nacionale dhe Plani i Veprimit Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore 2011-2014.

Synimi tjetër i këtyre politikave është administrimi i migrimit në të gjitha format që paraqitet, si dhe forcimi i bashkëpunimit me shtetet fqinje me qëllim të parandalimit të migrimit të parregullt dhe luftimit të trafikimit me njerëz dhe kontrabandimit me migrantë. Problemi i migrimit të parregullt lidhet ngushtë me procesin e eliberalizmit të vizave.

6.3. Programi aktual për riintegrim

Qeveria e Republikës së Kosovës ka përgatitur dhe miratuar kornizën e politikave për riintegrimin e personave të riatdhesuar, si dhe ka miratuar Rregulloren për Menaxhimin e Programit për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar.

Qeveria ka ndarë fondin e dedikuar për mbështetjen e riintegrimin të qëndrueshëm të shtetasve kosovarë të riatdhesuar në shumën prej 500,000 euro në vitin 2010, 3,420,150 euro në 2011, fondin prej 3,170,150 euro për vitin 2012 dhe shumën e njëjtë e ka ndarë edhe për vitin 2013.

Strukturat vendimmarrëse dhe koordinuese që merren me riintegrimin e personave të riatdhesuar në nivel qendror dhe lokal janë: Departamenti për Riintegrim në kuadër të MPB-së Bordi Koordinues Ndërmintor për Riintegrim dhe Sekretariati i tij, Zyrat Komunale për Kthim dhe Komunitete, dhe Komisionet Komunale për Riintegrim.

6.4. Bashkëpunimi me Organizatat Ndërkombëtare

6.4.1. Bashkëpunimi me IOM

Për të parandaluar migrimin e parregullt dhe për të promovuar migrimin e rregullt, Organizata Ndërkombëtare për Migrimin (IOM) në partneritet me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme të Qeverisë së Kosovës, kanë hapur Qendrat e Shërbimeve për Migrantë (QSHM) në Prishtinë, Mitrovicë, Gjiilan, Gjakovë, Ferizaj, Prizren dhe Pejë. Qendrat ofrojnë: informacione, shërbime këshillimi, referim në lidhje me migrimin në Bashkimin Evropian, Zvicër, SHBA, Kanada, Zelandën e Re dhe Australi. Po ashtu, ofrojnë informata mbi vizat, kushtet e punësimit dhe jetesës, studimin jashtë vendit, programet e

imigrimit, të drejtat dhe mbështetjen për migrantë, bashkimin familjar, programet e riintegrit në Kosovë për migrantët e kthyer. Gjithashtu, IOM në bashkëpunim me MPMS ka të planifikuar hapjen e disa zyrave komunale për promovimin e migrimit ligjor.

Që nga viti 1999 deri më 31 gusht 2012, janë kthyer përmes IOM vullnetarisht 200.147 individë. Numri më i madh është kthyer nga Gjermania 42.5% (85,027), Zvicra 17.3% (34,583), Austria (3.9%), Norvegjia (3.6%), Belgjika (2.9 %), Mbretëria e Bashkuar (2.2 %), Holanda (2.1%) etj.

IOM në bashkëpunim të ngushtë me institucionet e Kosovës ka implementuar programe të ndryshme për kthim dhe riintegrim të asistuar vullnetar me qëllim që përmes promovimit të kthimit dhe riintegrit të tyre të qëndrueshëm në Kosovë të parandaloj migrimin e parregullt.

6.4.2. Bashkëpunimi me UNHCR

UNHCR-ja ka ofruar përkrahje të rëndësishme për autoritetet e Kosovës në fushën e mbrojtjes së refugjatëve, azilit dhe migrimit. Ofrimi i ngritjes së kapaciteteve ka qenë prioritet për UNHCR-në në kuptim të zhvillimit dhe funksionimit të sistemit të azilit në Kosovë si dhe ka ofruar përkrahje teknike përmes asistimit në zhvillimin e legjislacionit, ngritjes së kapaciteteve dhe kushteve të pranimit si dhe përmirësimit të kualitetit të përcaktimit të statusit të refugjatit në instancën e parë dhe atë të dytë.

UNHCR-ja po ashtu ka ndihmuar në zhvillimin e strategjisë dhe mekanizmave për ripranim dhe riintegrim të personave të cilët kthehen kryesisht nga vendet e Evropës Perëndimore.

6.5. Bashkëpunimi me Shoqërinë Civile

Sa i përket bashkëpunimit me shoqërinë civile në sferën e migrimit, në fushën e azilit ekziston një bashkëpunim në ofrimin e ndihmës juridike të azilkërkuesve dhe përfaqësimit të tyre juridik. Po ashtu, në rast nevojë, këshillat psikologjike ofrohen përmes OJQ-je vendore. Synimi i ynë do të jetë që në të ardhmen ky bashkëpunim të forcohet dhe të jetë i vazhdueshëm edhe në fusha tjera.

6.6. Kontrolli në Kufi dhe Politika e Vizave

Parandalimi i migrimit të parregullt është një nga prioritetet kryesore për sigurinë dhe politikat e administrimit të flukseve të migrimit.

Sipas Departamentit të Kufirit, në vitin 2010 janë zbuluar 30 raste të kontrabandimit me migrantë, 14 raste në vitin 2011 dhe në vitin 2012 janë zbuluar 12 raste.

Republika e Kosovës e ka vendosur regjimin e vizave me 87 vende, kryesisht të kontinentit të Azisë dhe kontinentit të Afrikës. Aplikimi i regjimit të vizave ka filluar nga 1 Korriku i vitit

2013, fillimisht në shërbimin diplomatik dhe konsullor të Republikës së Kosovës në Republikën e Turqisë.

6.7. Ripranimi dhe kthimi

Republika Kosovës ka hartuar kornizën ligjore në fushën e ripranimit. Ligji për Ripranim përcakton rregullat dhe procedurat për ripranimin e personit i cili është shtetas i Republikës së Kosovës ose i jashtëm, i cili nuk i plotëson ose nuk i plotëson më tej kërkesat për hyrje ose qëndrim në territorin e shtetit kërkues. Zbatimi i legjislacionit për ripranim ka përparësi sa i përket bashkëpunimit për ripranim me vendet me të cilat Kosova ende nuk ka nënshkruar marrëveshje dypalëshe për ripranim.

Deri më tani, Qeveria e Republikës së Kosovës ka nënshkruar 19 marrëveshje bilaterale të ripranimit me 19 shtete të Bashkimit Evropian dhe shtete të zonës Shengen dhe me dy vendet e rajonit me Republikën e Shqipërisë dhe me Republikën e Malit të Zi.

Marrëveshjet dypalëshe për Ripranim	Datat e nënshkrimit marrëveshjes
Shqipëria	6 tetor 2009
Franca	2 dhjetor 2009
Zvicra	3 shkurt 2010
Gjermania	14 prill 2010
Danimarka	8 qershor 2010
Austria	30 shtator 2010
Norvegjia	15 tetor 2010
Sllovenia	10 maj 2011
Beneluksi	12 maj 2011
a)Belgjika	
b)Holanda dhe	
c)Luksemburgu	
Çekia	24 qershor 2011
Mali i Zi	30 qershor 2011
Suedia	4 tetor 2011
Finlanda	29 nëntor 2011
Hungaria	15 maj 2012
Bullgaria	19 qershor 2012
Malta	21 nëntor 2012
Estonia	17 maj 2013
Lihtenshtajni	16 qershor 2013
Kroacia	23 korrik 2013
TOTAL	19 marrëveshje

Tabela 1: Lista e shteteve me të cilat Republika e Kosovës ka marrëveshje dypalëshe për Ripranim.

SHTETET	KODI	GJITHSEJ	2010	2011	2012	2013 (01 janar – 30 qershor 2013)	GJITHSEJ NE %
GJITHSEJ		15934	5198	4488	4187	2061	100
BELGIKË	BE	1432	220	567	410	235	8.99
AUSTRI	AT	1741	888	423	260	170	10.93
BEH	BA	7	0	0	6	1	0.06
B.M	UK	129	47	37	40	5	0.81
DANIMARKË	DK	173	29	76	49	19	1.09
ESTONI	EE	1	0	0	1	0	0.01
FINLANDË	FI	416	213	92	80	31	2.6
FRANCË	FR	1332	377	445	369	141	8.36
GJERMANI	DE	2802	935	750	713	404	17.59
GREQI	EL	26	0	0	26	0	0.23
HOLANDË	NL	102	35	24	35	8	0.64
HUNGARI	HU	1324	328	363	527	106	8.31
IRLAND	IE	9	3	2	4	0	0.06
ITALI	IT	167	42	59	50	16	1.05
KANADË	CA	98	30	22	33	13	0.62
KROACI	CRO	206	45	52	78	31	1.29
LUKSENBURG	LU	230	101	47	65	17	1.44
MEKSIKË	MD	12	0	2	10	0	0.01
NORVEGJI	NO	611	274	171	115	51	3.9
POLONI	PL	2	2	0	0	0	0.01
PORTUGALI	PT	1	0	1	0	0	0.01
REP. ÇEKE	CZ	20	7	5	5	3	0.13
REP. SLLOVAKE	SK	12	4	1	7	0	0.08
RUMANI	RO	8	0	0	5	3	0.05
SHBA	US	149	20	31	86	12	0.94

SLLOVENI	SI	134	66	38	21	9	0.84
SPANJË	ES	14	3	2	5	4	0.09
SUEDI	SE	2300	793	627	556	324	14.55
TURQI	TU	14	0	6	2	6	0.09
ZVICËR	CH	2462	736	645	629	452	15.44

Tabela 2: Numri i personave të ripranuar, vullnetarë dhe detyrueshëm, sipas shteteve në vitin 2010, 2011 dhe 2012 dhe 2013 (Janar – Qershor 2013).

Procedurat e nënshkrimit të marrëveshjeve të ripranimit me Republikën e Letonisë dhe Italisë janë finalizuar dhe kanë mbetur vetëm të përfundojnë.

Republika e Kosovës ka riinicuar tentativat për fillimin e negociatave për marrëveshjet për ripranim me Mbretërinë e Bashkuar, Portugalinë, Lituanië, Poloninë dhe Irlandën.

Përsa i përket vendeve të transitit, Marrëveshja për Ripranim me Republikën e Maqedonisë është në fazën e negociimit, ndërsa i është propozuar Republikës së Turqisë.

Zbatimi i marrëveshjeve për ripranim është një faktor i rëndësishëm për parandalimin dhe luftimin e migrimit të parregullt. Analiza e zbatimit të marrëveshjeve për ripranim tregon qartë se ky instrument kontribuon për forcimin e një bashkëpunimi efikas në luftën kundër migrimit të parregullt dhe lehtëson largimin e personave që hyjnë/qëndrojnë ilegalisht në territorin e njëres prej palëve kontraktuese.

Procedurat për kthimin jovullnetar të të huajve janë në pajtim me legjislacionin nacional i cili garanton zbatimin e parimit të moskthimit të parashikuar në Konventën e 1951 lidhur me Statusin e Refugjatëve dhe Protokollin e zbatimit të vitit 1967.

Megjithatë, gjatë zbatimit të procedurave të kthimit të azilkërkuesve të refuzuar dhe të huajve me qëndrim të parregullt, organet kompetente të Republikës së Kosovës kanë ndeshur vështirësi në gjetjen e informacioneve dhe përcaktimin e identitetit të personave të cilët duhet të largohen nga Kosova.

Me qëllim të rritjes së efikasitetit të këtyre procedurave, është e rëndësishme që të krijohet dhe të forcohet bashkëpunimi ndërmjet përfaqësive diplomatike dhe konsullore të Kosovës me organet kompetente të vendeve prej të cilëve rezulton numri më i madh i azilkërkuesve dhe i emigrantëve të parregullt, në kontest të një politike evropiane të përbashkët për kthimin vullnetar të shtetasve të vendeve tjera në vendin e originës apo të vendqëndrimit të tyre, duhet të merren një sërë masash që kontribuojnë në zbatimin e procedurave për kthimin vullnetar.

Megjithatë, Kosova është e vendosur që të nënshkruaj marrëveshje për ripranim me vendet e origjinës dhe të transitit. Republika e Kosovës ka propozuar draftin e marrëveshjeve për ripranim me Republikën e Turqisë, dhe nëpërmjet kanaleve diplomatike, ka shprehur vullnetin e saj për të nënshkruar marrëveshje të tilla me Afganistanin, Pakistanin dhe Bregun e Fildishtë. Kjo është dhe një kërkesë që rrjedh nga Udhërrëfyesi për Liberalizimin e Vizave.

Menaxhimi i integruar i kufirit ndimon në parandalimin e migrimit të parregullt, e cila është një prej parakushteve për përmbushjen e kriterëve të integritit të Kosovës në Bashkimin Evropian si dhe kusht i rëndësishëm për procesin e liberalizimit të vizave me Bashkimin Evropian. Në bazë të Strategjisë për Menaxhimin e Integruar të Kufirit parashihen kufij të hapur por të kontrolluar dhe të sigurt.

Përgjegjësitë e agjencive të përfshira në menaxhimin e integruar të kufirit përfshijnë parandalimin dhe luftimin e migrimit të parregullt, të trafikimit me njerëz, të kërcënimeve të qetësisë dhe të rendit publik, rendit ligjor, sigurisë ndërkombëtare dhe marrëdhënieve ndërkombëtare të Kosovës. Po ashtu, këto përgjegjësi përfshijnë edhe ndëshkimin e kryesve të veprave penale në kufi.

Gjithashtu, agjencitë e ngarkuara me zbatimin e MIK-ut respektojnë të drejtat e azilkërkuësve dhe të viktimave të trafikimit që hyjnë në Kosovë dhe ju ofrojnë mbrojtje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet ndërkombëtare.

Si pjesë integrale e politikës qeveritare të parandalimit të migrimit të parregullt është edhe lëshimi i pasaportave biometrike. Me lëshimin e pasaportave biometrike, MPB përmbush një parakusht shumë të rëndësishëm, në rrafshin e sigurisë së dokumenteve, të parashikuar edhe nga udhërrëfyesi për liberalizimin e vizave.

Politikat e kthimit janë një element i rëndësishëm i administrimit të flukseve të migrimit dhe bazohen në dy elemente kryesore: kthimin vullnetar dhe të detyrueshëm, si dhe në punën që bëhet për inkurajimin e kthimit vullnetar.

6.8. Luftimi i trafikimit me njerëz

Mbrojtja e të drejtave të njerëzve të trafikuar duhet të jetë një parim udhëheqës i përpjekjeve për të parandaluar trafikimin me njerëz. Arsyet kryesore të trafikimit me njerëz janë varfëria dhe mungesa e zhvillimit ekonomik, niveli i ulët i edukimit si dhe vetëdijësimin të personave që janë me rrezik.

Grupet më të ndjeshme për trafikim janë vajzat e reja nga 18 deri në 30 vjeç, të miturat dhe fëmijët jetim, si dhe gratë dhe burrat e aftë për shfrytëzim pune. Viktimat e trafikimit vijnë kryesisht nga vende me nivel papunësie të lartë dhe zhvillim ekonomik të ulët. Metodot kryesore për tërheqje në rrjetet e trafikimit mbetet ofertat për punë, edukim jashtë vendit dhe propozimet për martesë.

Përpjekjet për të luftuar trafikimin me njerëz janë shtuar, po ashtu dhe numri i hetimeve dhe gjykimeve për raste tilla.


Sfida kryesore në luftën kundër trafikimit me njerëz mbetet ngritja e kapaciteteve, identifikimi i viktimave, mbrojtja , integrimi i tyre dhe mbrojtja e fëmijëve, veçanërisht e atyre që janë viktimë të trafikimit të përsëritur.

Me qëllim të parandalimit dhe luftimit trafikimit me njerëz është hartuar ligji i veçantë për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit.

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i dispozitave juridike përmes të cilave, autoriteteve kompetente vendore iu jepen të drejta, obligime dhe përgjegjësi, për parandalimin dhe luftimin trafikimit me njerëz në të gjitha format e tij, mbrojtjen e viktimave të trafikuar, përfshirë sigurimin e të drejtave, si ndihmë juridike, ndihmë mjekësore, mbështetje psiko- sociale, sigurimi i kompensimit dhe të drejtave të tjera, për të gjithë personat që supozohen të jenë ose që identifikohen si të trafikuar, pavarësisht moshës, gjinisë, fesë apo kombësisë së tyre, përmes një qasje të bazuar në të drejta të njeriut dhe me theks të veçantë të drejtat e fëmijëve, që ka ndjeshmëri për aspektet kulturore dhe gjinore, në përputhje të plotë me instrumentet dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar me qëllim të parandalimit dhe luftimit të trafikimi më njerëz, dhe sigurimit të ndihmës dhe mbrojtjes së viktimave të trafikuar.

	Kosovare	Moldave	Shqiptare	Rumune	Ukrainase	Bullgare	Serbe	Ruse	Maqedone	Polake	Tjera	Totali
2001	5	94	3	46	18	4	/	2	/		/	172
2002	3	32	9	19	20	6	/	/	/		/	89
2003	15	13	4	5	5	3	4	/	/		1	50
2004	11	17	13	4	/	2	/	/	/		1	48
2005	24	6	6	/	/	6	2	/	/		5	49
2006	20	30	6	/	3	2	/	2	/		3	66
2007	18	3	9	/	/	/	1	/	1		1	33
2008	25	4	3	/	/	1	2	/	/		1	36
2009	16	8	3	/	/	1	1	/	/		/	29
2010	28	1	7				2			1		39
2011	35		1				3					39
2012	29	23	1								1	54
2013												0
Totali	229	231	65	74	46	25	15	4	1	1	13	704

Statistikat e viktimave të trafikimit të identifikuar në Republikën e Kosovës 2001-2012.



A

	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	Totali
<i>Grafikim me njerëz</i>	25	22	11	56	33	36	46	68	34	76	91	121	619
<i>Mundësim i prostitucionit</i>	8	49	19		15	21	4	13	3	13	39	39	223
<i>Prostitucion</i>	15	88	33	10	12	12	13	9	9	27	50	61	339
<i>Vendosje e skllavërisë</i>			1		1						1		3
<i>Vepra tjera</i>	4	25	6	11	40	28	9	8	6	5	2	7	151
<i>Totali i arrestimëve</i>	52	184	70	77	101	97	72	98	52	121	183	228	1335

Arrestimet sipas veprave penale

6.9 Azili

Miratimi i procedurave të qarta për pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave për azil është vendimtare për menaxhimin efektiv të flukseve migratore të përziera. Në këtë aspekt, Kosova siguron qasje në procedurat e drejta të azilit për të huajt që kërkojnë mbrojtje në territorin e saj,

në përputhje me standardet ndërkombëtare të vendosura nga Konventa e Gjenevës 1951 në lidhje me Statusin e Refugjatëve dhe Protokollit të saj të vitit 1967, si dhe direktivat përkatëse të BE-së.

Sipas legjislacionit vendor për azil, statusi refugjatit i jepet përmes procedurës së përcaktimit individual, e cila përbëhet nga një vlerësim i plotë në bazë të meritave të kërkesës. Ligji gjithashtu parashikon mbrojtje të përkohshme që do të jepet për grupet e njerëzve në rastet e flukseve masive të huajve të cilët janë të detyruar të largohen nga vendet e tyre të origjinës. Në mënyrë të ngjashme, mbrojtja plotësuese duhet të jepet personave të cilët nuk i plotësojnë kriteret për statusin e refugjatit, por për të cilët kthimi në vendin e origjinës nuk është i mundur pasi ata mund të jenë të ekspozuar ndaj torturës apo trajtime të tjera jo-njerëzore dhe degraduese.

Qendra për Azilkërkues është funksionale, me kapacitet për të akomoduar deri në 50 azilkërkues. Qendra për Azilkërkues organizon akomodimin, kontrollin mjekësor, ndihmën mjekësore dhe sociale të personave të cilët kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare. Qendra është e tipit të hapur që nënkupton se azilkërkuesit e akomoduar janë të lirë të lëvizin duke respektuar rregullat e brendshme të Qendrës.

Viti	2009	2010	2011	2012	2013*	Gjithsej
Numri	31	267	189	45	41	573

Tabela 3: Numri i azilkërkuesve sipas statusit të Vendimit (2013*, 1 Janar – 30 Qershor)⁶

Kontinenti	2009	2010	2011	2012	2013*	Gjithsej sipas Kontinenteve
Afrika	3	60	54	19	16	129
Azia	27	204	135	26	25	378
Evropa	1	3	0	0	0	4
Totali	31	267	189	45	41	573

Tabela 4: Numri i azilkërkuesve sipas Kontinentit (2013*, 1 Janar – 30 Qershor)⁷

Forma e Hyrjes	2009	2010	2011	2012	2013*	Gjithsej
Ilegale	20	212	183	45	36	439
Legale	11	55	6	0	5	72
Totali	31	267	189	45	41	573

Tabela 5: Forma e hyrjes së Azilkërkuesve në Kosovë (2013*, 1 Janar – 30 Qershor)⁸

⁶ Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion

⁷ Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion

⁸ Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion

6.10. Shtetësia dhe natyralizimi

Politikat për dhënien e shtetësisë së Kosovës janë element i rëndësishëm për administrimin e proceseve të migrimit. Kjo është e kombinuar me monitorimin dhe kontrollin e procesit dhe parandalimin e akteve që paraqesin kërcënim për sigurinë e brendshme. Konform legjislacionit është e rëndësishme që dhënia e shtetësisë të ofrohet edhe për personat që e fitojnë statusin e refugjatit e të cilët mund t'i kontribuojnë zhvillimit të shoqërisë sonë. Numri më i madh i kërkesave për humbje shtetësie paraqitet nga shtetas kosovarë të cilët fitojnë shtetësinë në shtete të cilat nuk pranojnë shtetësinë e dyfishtë. Kjo sjell si pasojë një ulje të numrit të popullsisë me shtetësi të Kosovës. Duke pasur parasysh lidhjet e veçanta të kësaj kategorie me Kosovën, statusi i tyre është rregulluar sipas Ligjit për të Huajt. Për rrjedhojë është paraparë mundësia e pajisjes së tyre me leje qëndrim të përhershëm.

Përsa i përket dhënies së shtetësisë, një pjesë e kërkesave bëhet nga persona me origjinë të Kosovës. Ligji për Shtetësi i Kosovës që rregullon kushtet për fitimin, humbjen apo rifitimin e saj, është ndryshuar në vitin 2011 dhe tani është rishikuar në tërësi ky ligj. Këto ndryshime kanë sjellë si pasojë lehtësira për dhënien e shtetësisë personave me origjinë të Kosovës dhe kanë zbutur kriterin e qëndrimit për fitimin e shtetësisë së Kosovës për refugjatët. Me qëllim të parandalimit të pashtetësisë, ligji ka të inkorporuar dispozita të cilat i lejojnë personat pa shtetësi të fitojnë shtetësinë e Kosovës.

6.11. Parandalimi dhe luftimi i migrimit të parregullt brenda Republikës së Kosovës

Strategjia dhe Plani i Veprimit si objektivi kryesor ka parandalimin dhe luftimin e migrimit të parregullt konform politikave dhe kriterëve të BE-së. Në zbatim të kësaj, është bërë harmonizimi i legjislacionit vendor me atë të BE-së lidhur me migrimin.

Në kuptim të kësaj, njëra ndër çështjet kyçe në këtë dokument strategjik është edhe avancimi i bashkëpunimit me faktorët rajonal dhe ndërkombëtar në promovimin dhe adaptimin e politikave të përbashkëta në luftimin e migrimit të parregullt.

Parimet universale të të drejtave të njeriut, lirisë së lëvizjes, të drejtave të azilkërkuesve dhe refugjatëve, respektohen konform Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ligjeve në fuqi dhe standardeve ndërkombëtare.

Masa e urdhër largimit u është shqiptuar 337 personave.

Shtetësia	Nr. i Personave	Shtetësia	Nr. i Personave
Shqipëria	195	Filipine	2
Serbia	31	Kinë	2
Rumania	18	Bangladesh	1
Bulgaria	18	BiH	1

Maqedonia	15	Kamerun	1
Turqia	15	Nigeria	1
Moldavia	13	Tailandë	1
India	10	Afganistan	1
Franca	5	Rusisë	1
Ukraina	5	Iranit	1

Tabela 7.2.2 Shtetësia dhe numri i personave të cilëve u është shqiptuar masa e urdhër largimit.

Parandalimi dhe luftimi i migrimit të parregullt brenda territorit të Republikës së Kosovës do të intensifikohet përmes zbatimit të plotë të dispozitave të Ligjit për të Huajt, me të cilin rregullohen në mënyrë decisive veprimet që duhen të ndërmerren nga organet kompetente ndaj personave të cilët në Republikën e Kosovës janë me qëndrim të parregullt.

Masat dhe veprimet konkrete në parandalimin dhe luftimin e migrimit të parregullt brenda territorit të Republikës së Kosovës, janë të parapara të realizohen përmes objektivave strategjike në planin e veprimit të këtij dokumenti strategjik.

VII. Politikat e ardhshme

Qeveria e Republikës së Kosovës përmes kësaj strategjie do të mundësojë implementimin e prioriteteve dhe të politikave sektoriale në përputhje me interesat shtetërore dhe prioritetet sipas kërkesave të BE-së. Domosdoshmërisht politikat e parashikuara me këtë strategji janë të lidhura ngushtë me parimet themelore dhe me politikat e përgjithshme të BE-së në fushën e migrimit dhe azilit.

7.1. Kontrolli kufitar

Kontrolli kufitar është një pjesë përbërëse dhe element kyç i një politike migrimi efektive, e cila ndihmon në parandalimin e migrimit tëparregullt. Kosova do të përmbushë të gjitha detyrimet për zbatimin e standardeve evropiane në kontrollin e kufirit në përputhje me legjislacionin e BE-së.

Autoritetet përgjegjëse për menaxhimin e kufijve do t'i avancojnë mekanizmat dhe procedurat përkatëse për identifikimin e personave që mund të kenë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare dhe përpunimin e kërkesave të tyre, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe standardet ndërkombëtare.

Është i domosdoshëm një thellim i bashkëpunimit me FRONTEX me qëllim të forcimit të kapaciteteve të Policisë Kufitare, përmes pjesëmarrjes në programet e tyre të trajnimit.

7.2. Politika e vizave

Si element i rëndësishëm i politikës së migrimit, politika e vizave synon forcimin e masave të sigurisë, duke respektuar të drejtat e shtetasve të huaj. Kosova është e vetëdijshme për rëndësinë e zbatimit të politikës së regjimit të vizave.

Në këtë drejtim ekziston legjislacioni adekuat për çështjet që ndërlidhen me regjimin e vizave dhe i njëjti është i harmonizuar me legjislacionin e BE-së. Me qëllim të parashikimit të garancive ligjore për mbrojtjen e sigurisë kombëtare dhe parandalimin e korrupsionit, legjislacioni parashikon rrugët e ankimit dhe inspektimin e veprimeve të kryera nga autoritetet kompetente për lëshimin e vizave në rastet e refuzimit.

Gjithashtu, është themeluar sistemi informativ për zbatimin e regjimit të vizave dhe është në proces të zhvillimit. Ky sistem, përveç në MPJ, është vendosur në pikat e kalimit kufitar dhe në Divizionin për të Huajt që vepron në kuadër të DSHAM-së. Në të ardhmen Qeveria e Republikës do t'a funksionalizojë në terësi sistemin e regjimit të vizave.

7.3. Migrimi i parregullt dhe kthimi në vendin e origjinës

Politika e kthimit është mjet i rëndësishëm që ndikon në pengimin e migrimit të parregullt, duke dërguar një mesazh të qartë tek migruesit potencial, se respektimi i dispozitave ligjore është mënyra e vetme për të përfituar nga migrimi. Rezultatet optimale mund të arrihen vetëm nëse politika e kthimit kombinohet me sistemin e menaxhimit efektiv të kufirit dhe politikës së azilit, po ashtu me aranzhimet adekuate të integritetit dhe pranimit ligjor. Në anën tjetër, çështjet e kthimit dhe integritetit shkojnë përtej politikës së migrimit e që janë elemente kyçe të politikës së të huajve dhe bashkëpunimit me vendet e origjinës dhe vendet transite të flukseve ndërkombëtare të migrimit.

Kosova do të ndjekë një politikë të kthimit, transparente, humane dhe të ekuilibruar, në përputhje me parimin e mos-dëbimit dhe duke marrë në konsideratë të drejtat e personit dhe situatën në vendin e origjinës. Programet për kthim nuk synojnë vetëm migrantët e parregullt dhe azilkërkuesit e refuzuar, por ofrojnë ndihmë edhe migrantëve ligjor të cilët dëshirojnë të kthehen në vendin e origjinës.

Politikat e kthimit do t'i japin përparësi kthimit vullnetar si mundësi e parë. Kjo sepse kthimi vullnetar dhe pëlqimi i personit që kthehet duhet të kontribuojë në zbatimin e politikave të kthimit dhe respektimin e dinjitetit të personit që kthehet, sigurimin e bashkëpunimit me personin që kthehet dhe qëndrueshmërinë e masave kthyese, përmirësimin e proceseve të kthimit sa i përket kohës dhe shpenzimeve. Kthimi i detyrueshëm do të zbatohet si masë e fundit nëse personi i shmanget kthimit vullnetar.

Me qëllim të përmbushjes së këtyre masave, Republika e Kosovës do të fokusohet në:

- Përkushtimin e vazhdueshëm për nënshkrimin e marrëveshjeve për ripranim me vendet e origjinës dhe të transitit të flukseve të migrimit të parregullt;
- Krijimin dhe përmirësimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe koordinimin e punës së institucioneve përgjegjëse për menaxhimin e kthimit;
- Ngritjen e profesionalizmit dhe trajnimin e vazhdueshëm të stafit të përfshirë në kthimin e detyrueshëm dhe kthimin vullnetar;
- Themelimin dhe funksionalizimin e Qendrës për Pranimin e të Huajve;
- Ngritjen e bashkëpunimit me shtetet e BE-së, FRONTEX, EASO, MARRI dhe iniciativave tjera;
- Harmonizimin e politikave për kthim me standardet e BE-së me qëllim të krijimit të politikave të kthimit dhe të ripranimit;
- Krijimin e programeve të veçanta për ndihmën për kthim vullnetar;
- Rritjen e bashkëpunimit në fushën e ndihmës për kthim vullnetar me organizatat ndërkombëtare dhe jo-qeveritare;
- Forcimin e kapaciteteve të institucioneve që merren me ekzekutimin e kthimit lidhur me mbrojtjen e të dhënave gjatë procesit të administrimit të mirë të migrimit.

7.4. Luftimi i trafikimit me njerëz

Duke pasur parasysh pozitën gjeografike të Kosovës, luftimi i trafikimit me njerëz mbetet në qendër të vëmendjes së politikës së migrimit. Me qëllim të luftimit efikas të trafikimit me njerëz, është aplikuar një qasje e integruar me fokus:

- Në parandalimin e të gjitha formave të trafikimit dhe përsëritjen e trafikimit;
- Hetimin dhe dënimin e trafikuesve;
- Përmirësimin e procedurave për kthim, mbrojtjen dhe integrimin e viktimave;
- Forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar;
- Mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe ofrimin e ndihmës për viktimat dhe dëshmitarët;
- Zbatimin e masave anti-korrupsion, në veçanti kundër përfshirjes të zyrtarëve policorë, prokurorëve, gjyqtarëve apo zyrtarëve të tjerë;
- Hetime paraprake, përfshirë edhe përmirësimin e bashkëpunimit, mbledhjen dhe analizimin e të dhënave të policisë dhe të institucioneve të tjera.

7.5. Politikat e azilit

Kosova është e vendosur për zhvillimin dhe fuqizimin e politikave dhe praktikave të azilit lidhur me përcaktimin e statusit të refugjatit dhe mbrojtjen e personave në nevojë, në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe të drejtën ndërkombëtare. Për rrjedhojë, koordinimi ndërmjet institucioneve që merren me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të të huajve që kërkojnë mbrojtje në Kosovë është esencial.

Kosova e ka bërë harmonizimin e legjislacionit të azilit me legjislacionin e BE-së. Përmbushja e një prej kriterëve që rrjedhin nga udhërrëfyeni lidhet pikërisht me forcimin e bashkëpunimit me Zyrën Evropiane për Mbështetje të Azilit (EASO). Në këtë kuadër ka filluar bashkëpunimi me EASO-në duke shkëmbyer pyetësorin standard për gjendjen e migrimit dhe azilit. Vlen të përmendet edhe vizita e zyrtarëve të EASO-së në Republikën e Kosovës në korrik të këtij viti. Institucionet e përfshira në procesin e përcaktimit të statusit të refugjatit do të përqendrojnë vëmendjen në trajnime lidhur me informatat për vendin e origjinës, përmirësimin e cilësisë së procesit dhe procedurave të azilit dhe forcimin e strukturave administrative. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet garantimit të të drejtës për të kërkuar azil, të drejtave të ankimit, respektimit të afateve dhe fuqizimit të pavarësisë së shkallës së parë dhe të dytë në kuadër të procesit të azilit.

7.6. Politikat e migrimit, zhvillimit dhe të integrimit

Kosova e ka bërë harmonizimin e legjislacionit dhe hartimin e politikave lidhur me hyrjen dhe qëndrimin e të huajve. Duke pasur parasysh lidhjen e ngushtë që ekziston ndërmjet migrimit dhe zhvillimit ekonomik, kjo politikë synon krijimin e një kuadri ligjor për migrimin ligjor, duke marrë parasysh dhe integrimin e të huajve në shoqërinë e Kosovës. Masat për migrim ligjor kanë të bëjnë me kushtet e hyrjes dhe të qëndrimit të disa kategorive të migrantëve, siç janë punëtorët e kualifikuar, studentët dhe kërkuesit shkencor. Këto masa mbulojnë gjithashtu bashkimin familjar dhe qëndrimin afatgjatë.

Kosova do të bëjë përpjekje lidhur me integrimin e shtetasve të huaj dhe kjo politikë integrimi duhet të lidhet ngushtë me kërkesën e tregut të punës për punëtorë. Në këtë drejtim, një vlerësim i tregut të punës dhe hartimi i prioritetëve është më se i domosdoshëm. Bashkëpunimi me vendet e origjinës dhe të transitit duhet të forcohet nëpërmjet nxitjes dhe nënshkrimit të marrëveshjeve të partneritetit dhe migrimit qarkor.

Kosova do t'i japë një rëndësi të veçantë aspektit pozitiv të lidhjes që ekziston ndërmjet migrimit dhe zhvillimit si element i administrimit të migrimit.

Autoritetet kompetente duhet të bëjnë analiza të rregullta lidhur me numrin e personave të cilëve ju është dhënë shtetësia e Kosovës dhe integrimi i tyre social. Kosova duhet të rrisë përpjekjet e saj me qëllim të dhënies së shërbimeve dhe mbështetjes së migrantëve kosovarë, kryesisht nëpërmjet misionëve konsullorë dhe diplomatike.

Mekanizma efikas bashkëpunimi duhet të krijohen ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë me universitete me qëllim që të tërhiqen migrantët e kualifikuar.

Është e domosdoshme që të ndiqet një politike efektive për mbrojtjen e të drejtave themelore të migrantëve duke planifikuar masa për ndihmë ligjore disa grupeve të caktuara të interesit, duke ju respektuar të drejtën për përkthim dhe interpretim dhe parandalimin e ksenofobisë dhe të diskriminimit.

7.7. Përmirësimi i sistemit institucional dhe krijimi i mekanizmave

Ministria e Punëve të Brendshme, në përputhje me kompetencat e saj ligjore, luan një rol drejtues në zbatimin dhe koordinimin e administrimit të migrimit. Analiza e kryer dhe prioritetet si dhe politikat e formuluar tregojnë për vendosjen një autoriteti që do të jetë përgjegjës për koordinimin e strukturave në procesin e migrimit. Puna e e tij organizohet nga një sekretariat brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme. Ky autoritet do të monitoroj edhe arritjen e objektivave të strategjisë dhe do t'i raportojë Koordinatorit Nacional për Migrim.

Ky autoritet vepron si një hallkë ndërlidhëse ndërmjet institucioneve përkatëse, autoriteteve lokale dhe sektorit jo qeveritar të përfshirë në administrimin e migrimit.

Ky autoritet ka rol zbatues dhe kontrollues lidhur me:

- Monitorimin e vazhdueshëm të zbatimit të politikave të migrimit;
- Observimin dhe analizën e objektivave të politikës së migrimit;
- Dhënien e ekspertizës lidhur me ndryshimet legislative;
- Bashkëpunimin dhe koordinimin me institucionet dhe organizatat ndërkombëtare lidhur me dhënien e ndihmës teknike në fushën e azilit dhe të migrimit;
- Inicimin e kurseve të trajnimit që synojnë forcimin e kapaciteteve të zyrtarëve që punojnë në fushën e migrimit, azilit dhe integritit;
- Zhvillimin e hulumtimeve në fushën e migrimit në bashkëpunim me institucionet kërkimore, shkencore dhe rrjetet akademike;
- Shqyrtimin e mënyrave të bashkëpunimit me iniciativat rajonale në fushën e migrimit, azilit dhe refugjatëve.

7.8. Migrimi ligjor

Politikat promovuese të migrimit ligjor nga BE-ja kanë ardhur edhe si rezultat i miratimit të Programit të Hagës nga ana e Këshillit të Evropës, i cili program vërteton se migrimi ligjor luan rol të rëndësishëm në zhvillimin e ekonomisë së bazuar në dituri dhe se ndikon në arritjen e implementimit të Strategjisë së Lisbonës.

Migrimi ligjor është pjesë e lirisë së lëvizjes që është një nga të drejtat themelore të BE-së dhe Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, dhe e cila garantohet edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Republika e Kosovës është e përkushtuar të zbatoj legjislacionin për migrimin ligjor në pajtim me legjislacionin e BE-së. Politikët synojnë vendosjen e kornizës për migrimin ligjor duke marrë plotësisht parasysh rëndësinë e integritet në shoqërinë pritëse. Masat e BE-së për migrimin ligjor përfshijnë kushtet e hyrjes dhe qëndrimit për kategori të caktuara të migrantëve, si: punëtorët me kualifikim të lartë subjekt i direktivave të Kartës Blu të BE-së, studentëve dhe hulumtuesve. Organet kompetente të Republikës së Kosovës obligohen që të publikojnë kohë pas kohe informata në lidhje me ndonjë marrëveshje të arritur me vendet e BE-së, ndryshimet ligjore dhe informatat tjera të rëndësishme për punësim dhe edukim.

7.9. Profili i migrimit

Një ndër objektivat kryesore të politikës së strategjisë është krijimi i mekanizmave efektiv për menaxhimin dhe monitorimin e flukseve të migrimit. Për këtë arsye është i nevojshëm menaxhimi efektiv i migrimit, kornizës instucionale dhe politikave. Mungesa e informatave të sakta dhe statistikave për numrin e migruesve punëtorë, ligjorë dhe joligjorë është i dëmshëm për zhvillimin e politikave të menaxhimit efektiv të migrimit. Kuptimi i politikës nacionale të migrimit kërkon përpunim adekuat dhe qasje të të dhënave krahasuese të migrimit ndërkombëtar, koordinim nacional i politikave dhe bashkëpunim aktiv ndërmjet autoriteve të përgjegjëse.

Pë këtë arsye nevoja për vendosjen e profilit të migrimit, do të përfshijë:

- Analizimin e gjendjes momentale në grumbullimin dhe analizimin e të dhënave/statistikave;
- Identifikimin e zbrastirave në analizat dhe zhvillimi i rekomandime praktike bazuar në përvojën e vendeve anëtare të BE-së dhe/apo vendeve fqinje me qëllim të rritjes së statistikave në fushën e migrimit në vend;
- Fuqizimin e kapaciteteve të Qeverisë për kuptimin dhe vlerësimin e burimeve aktuale dhe potenciale për migrimin e rregullt dhe të parregullt dhe efektivitetin nacional dhe regjional të politikave të migrimit.

Profili i migrimit duhet të zgjeroj dijen për migrim dhe të aftësoj vlerësimin se si migrimi ndikon në zhvillimin dhe përmirësimin e përdorimit të kujdesëm në shpërndarjen e informatave ekzistuese të migrimit ndërmjet akterëve relevant.

Profili i migrimit do të shërbej edhe si dokument politik me qëllim të identifikimit dhe orientimit të politikave në fushën e migrimit me karakter ekonomik. Transformimi i lëvizjeve migratore si dhe menaxhimi i kontrollit të tyre do t'i shërbejnë Qeverisë së Republikës së Kosovës në evidencën e saktë për nevoja shtetërore.

MPB/DSHAM do të përditësoj të dhënat zyrtare nga akterët kompetent, duke përdorur të dhënat zyrtare nga lëvizjet e azilkërkuesve me të dhënat nga procesi i riintegrit, si dhe nga kategoritë tjera migratore.

VIII. Kuadri strategjik

8.1. Vizioni

Vizioni i Strategjisë është menaxhimi i suksesshëm i migrimit, parandalimi i migrimit të parregullt dhe caktimi i aktiviteteve për parandalimin dhe reduktimin e migrimit të parregullt.

8.2. Misioni

Misioni i Strategjisë Kombëtare të Migrimi është parandalimi i të gjitha formave të migrimit të parregullt, promovimi i migrimit të rregullt dhe harmonizimi i veprimeve shtetërore me ato ndërkombëtare për arritjen e objektivave në fushën e migrimit.

IX. Objektivat strategjike

Me objektivat strategjike do të përcaktohet mënyra konkrete e veprimeve në arritjen e rezultateve dhe sensibilizimin e institucioneve dhe mekanizmave institucional në fushën e migrimit.

Objektivat strategjike janë:

1. Parandalimi dhe luftimi i migrimit të parregullt;
2. Përmirësimi i menaxhimit të migrimit ligjor dhe qarkullues;
3. Transformimi dhe zhvillimi i migrimit në faktorë pozitiv ekonomik.

- 1. Parandalimi dhe luftimi i migrimit të parregullt:** Me qëllim të parandalimit të të gjitha formave të migrimit të parregullt, duke zhvilluar kapacitete institucionale dhe duke krijuar mekanizma për identifikimin dhe hetimin e personave që mundësojnë migrimin e parregullt dhe trafikimin me njerëz.

Objektivat specifike

1. Ngritja e vetëdijes për rreziqet dhe pasojat e migrimit parregullt;
2. Avancimi i sistemit të kontrollimit të hyrjes dhe qëndrimit të huajve në Republikën e Kosovës;
3. Fuqizimi i kapaciteteve të mbrojtjes ndërkombëtare që ofron Republika e Kosovës;
4. Rritja e efikasitetit në mbikëqyrjen dhe kontrollin e kufirit në Republikën e Kosovës;

5. Avancimi i luftimit të migrimit të pa rregullt;
6. Avancimi i luftimit të trafikimit me njerëz;
7. Përmirësimi i sistemit institucional për bashkëpunimin dhe bashkërendimin me qëllim të administrimit të migrimit;
8. Fuqizimi i sistemit të regjimit të vizave.

2. Përmirësimi i menaxhimit të migrimit ligjor dhe qarkullues: Menaxhimi i migrimit rezulton me krijimin e bazës së mirë ligjore sipas legjislacionit të BE-së, si dhe implementimin e legjislacionit në teren përmes institucioneve vendore dhe në bashkëpunim me shtetet tjera.

Objektivat specifike

1. Kompletimi i kornizës ligjore dhe fuqizimi i kapaciteteve për të menaxhuar migrimin;
2. Avancimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e migrimit.

3. Transformimi dhe zhvillimi i migrimit në faktorë pozitiv ekonomik: Zhvillimi ekonomik i vendit ka në vete edhe faktorin migrator përmes të cilit duke transformuar lëvizjet migratore në faktor ekonomik, reflekton në zhvillimin ekonomik të vendit përmes remitancave të ndryshme, si dhe përmes krijimit të mekanizmave apo politikave fiskale të efektshme për migrantët në Kosovë.

Objektivat specifike

1. Promovimi i integritit të huajve më qëndrim të ligjshëm;
2. Krijimi i politikave nxitëse për tërheqjen e shtetasve të huaj me qëllim të integritit të tyre në ekonominë e Kosovës.

X. Instrumentet ndërkombëtare

Konventat dhe aktet ndërkombëtare të cilat aplikohen në Republikën e Kosovës të përcaktuara me Kushtetutë përfshijnë, por nuk janë të kufizuara në listën e paraqitur në aneksin e mëposhtëm.

XI. Zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi i strategjisë

11.1 Roli i sistemit të monitorimit

Procesi i zbatimit të strategjisë do të jetë një proces i realizimit të objektivave strategjike, objektivave specifike si dhe aktiviteve. Monitorimi dhe vlerësimi i realizimit të objektivave dhe efektshmërisë së aktiviteve përkatëse, janë pjesë integrale e strategjisë dhe komponentë kryesorë e procesit të zbatimit të saj. Monitorimi dhe vlerësimi do të shërbejë për të ndjekur ecurinë e strategjisë, për të matur në proces shkallën e realizimit të objektivave të saj, veçanërisht të aktiviteve të përcaktuara.

Procesi i monitorimit do të realizohet nga institucionet përgjegjëse me pjesëmarrjen e gjerë të grupeve të interesuara.

Dimensionet kryesore të monitorimit dhe vlerësimit të strategjisë janë:

- Kapacitetet institucionale;
- Treguesit e monitorimit përgjatë dhe në fund të periudhës pesë (5) vjeçare;
- Burimet e informacionit dhe instrumentet matëse;
- Shpërndarja dhe përdorimi i rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit.

11.2. Strukturat institucionale për monitorim dhe vlerësim

Sistemi i monitorimit dhe vlerësimit, do të shtrihet në të gjitha institucionet bartëse dhe përgjegjëse për realizimin e objektivave të përcaktuara në strategji dhe planin e veprimit.

- Ministria e Punëve të Brendshme, është bartëse dhe përgjegjëse kryesore për monitorimin dhe koordinimin e zbatimit të objektivave;
- Koordinatori Nacional është përgjegjës për koordinimin, bashkërendimin, monitorimin, dhe raportimin ndër-institucional;
- Sekretaria në kuadër të DSHAM-së do të monitorojë treguesit më të rëndësishëm që kanë të bëjnë me migrimin dhe duhet të përgatisë raporte periodike për progresin e realizimit të objektivave;
- Ministrinë përkatëse do të përgjigjen për monitorimin dhe vlerësimin e aktiviteve që janë si bartës ose institucione në vartësi të tyre. Këto institucione do t'i raportojnë periodikisht Koordinatorit Nacional në mënyrë që raportet të jenë të unifikuara;
- Organizatat jo-qeveritare do të marrin pjesë në monitorimin dhe vlerësimin e strategjisë në tryeza të përbashkëta që do të organizohen nga koordinatori. Në këto tryeza, shoqëria civile do të paraqes raporte vëzhguese që lidhen me projektet dhe programet që ato kanë realizuar.

11.3. Zgjedhja e treguesve të monitorimit dhe vlerësimit

- Rënia e numrit të azilkërkuesve në shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Shengen;
- Rritja e numrit të kthimeve në vendin e origjinës së azilkërkuesve me vendim negativ në Republikën e Kosovës dhe rritja e numrit të largimit të personave me qëndrim të paligjshëm;
- Rritja e numrit të marrëveshjeve me vendet e zhvilluara për punësim sezonal, aftësim dhe trajnim;
- Raportet e monitorimit dhe vlerësimit të strategjisë;
- Numri i fushatave vetëdijësuese për rrezikun që paraqet migrimi i parregullt.

11.4. Instrumentet e monitorimit dhe vlerësimit

- Sistemi i standardizuar i mbledhjes dhe përpunimit të informacionit;
- Të dhënat administrative dhe statistikore të institucioneve përkatëse;
- Mekanizmat shtetëror dhe ndërkombëtar referues;
- Anketime dhe vërtetime të popullatës mbi shkallën e vetëdijesimit lidhur me migrimin e parregullt, si dhe mundësisë së migrimit ligjor dhe qarkor.

11.5 Shpërndarja dhe përdorimi i rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit

Rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit do të shpërndahen për të bërë të njohur progresin e rregullimit të migrimit të rregullt dhe reduktimit të migrimit të parregullt, përkatësisht në arritjen e objektivave strategjike dhe objektivave specifike. Pasi të hartohen raportet e progresit bazuar mbi të dhënat dhe vërtimet, ato do të shpërndahen ndërmjet përdoruesve të cilët do të jenë:

- Institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale;
- Partnerët ndërkombëtarë;
- Shoqëria civile;
- Mediat;
- Publiku i gjerë.

Përgjegjës kryesor për shpërndarjen e rezultateve është MPB-ja. Gjithashtu, publikimi i rezultateve do të bëhet edhe nëpërmjet mediave ose duke organizuar seminare dhe tryeza për të nxjerrë konkluzione në lidhje me ecurinë e strategjisë.

XII. PLANI I VEPRIMIT

Plani i veprimit hartohet brenda kornizës së përgjithshme strategjike të përcaktuar në Strategjinë Shtetërore për Migrim.

Plani i Veprimit për zbatimin e kësaj strategjie përmban:

- Objektivat e strategjike;
- Objektivat specifike;
- Aktivitetet konkrete për realizimin e objektivave;
- Institucionet përgjegjëse;
- Institucioni mbështetëse;
- Afatet kohore për realizimin e secilit aktivitet;
- Koston financiare;
- Indikatorët apo treguesit për realizimin e secilit objektiv dhe aktivitet.

Plani i Veprimit duhet të tregoj lidhshmëri me kornizën e përgjithshme të Strategjisë Shtetërore për Migrim të Republikës së Kosovës.

XIII. Anekset

13.1. Korniza ligjore

Republika e Kosovës posedon një bazë të gjerë legislative e cila përfshinë, por nuk është e kufizuar në:

1. Kushtetutën e Republikës së Kosovës;
2. Ligjin për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror;
3. Ligjin për Azil;
4. Ligjin për të Huajt;
5. Ligjin për Ripranim;
6. Ligjin për Vendbanimin dhe Vendqëndrimin;
7. Ligjin për Shtetësinë e Kosovës;
8. Ligjin për Mërgatën e Kosovës;
9. Ligjin për Gjendjen Civile;

10. Ligjin për Shërbimin Konsullor të Misioneve Diplomatike dhe Konsullore të Republikës së Kosovës;
11. Ligjin për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës;
12. Kodin Penal të Kosovës;
13. Kodin e Procedurës Penale;
14. Ligjin për Policinë;
15. Ligjin mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale;
16. Ligjin për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë;
17. Ligjin për Prokurorinë e Shtetit;
18. Ligjin për Gjykatat;
19. Kodin Penal për të Mitur.

13.2. Instrumentet ndërkombëtare

Konventat dhe aktet ndërkombëtare të cilat aplikohen në Kosovë përfshijnë, por nuk janë të kufizuara në:

1. Deklaratën Universale mbi të Drejtat e Njeriut;
2. Konventën e Gjenevës 1951 në lidhje me Statusin e Refugjatëve dhe Protokolli i saj i vitit 1967;
3. Konventën e Nju Jorkut për Personat pa Shtetësi;
4. Konventën e OKB-së për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Gruas;
5. Konventën e OKB-së 1984 kundër Torturës dhe Trajtimit ose Ndëshkimit Tjetër Mizor, Jo-human dhe Poshtëruës;
6. Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;
7. Konventa e OKB-së mbi të Drejtat e Fëmijës;
8. Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Protokollet e saj.